

QYTETARËT DHE POLICIA

**Doracak mbi të drejtat dhe obligimet
tuaja lidhur me punën e policisë**



Botuesi

Akcija za ljudska prava (Aksioni për të Drejtat e Njeriut)

Human Rights Action (HRA)

81 000 Podgoricë, Mali i Zi

Tel: 020/232-348

hra@t-com.me

www.hraction.org

Për botuesin

Tea Gorjanc – Preleviq

Redaktoi

Tea Gorjanc – Preleviq

Autorët/et

Ana Shushoviq

Bojana Malloviq

Dalibor Tomoviq

Milica Bullatoviq – Jokanoviq

Tea Gorjanc- Preleviq

Përkthimi

Valbona Hoxhiq

Lekturimi

Agjencia e Përkthimit Porta Aperta, sh.p.k.

Ilustrimet

Adela Zejnilloviq

Mario Gjorgjeviq

Doracaku u përgadit në kuader të projektit “Njihni të drejtat tuaja - qytetari dhe policia” të cilin HRA e zbaton përmes programit “OSHC - të në Mal të Zi - nga shërbimet bazë në formësimin e politikave - M'Base” i cili zbatohet nga Qendra për Arsimimin Qytetar në partneritet me fondacionin gjerman Friedrich Ebert (FES), OJQ Qendra për Mbrojtjen dhe Studimin e Zogjve të Malit të Zi (CZIP) dhe OJQ Rrjeti Politikon, e në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike dhe Ministrinë e Çështjeve Evropiane të Qeverisë së Malit të Zi. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe bashkë financohet nga Ministria e Administratës Publike. Përmbajtja e tij është përgjegjësi ekskluzive e Aksionit për të Drejtat e Njeriut dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e donatorëve.

Publikimi i doracakut u mbështet nga Ministria e Punëve të Brendshme të Malit të Zi.

QYTETARËT DHE POLICIA

**Doracak mbi të drejtat dhe obligimet
tuaja lidhur me punën e policisë**

Përmbajtje

1. Kujt mund t'i ankohem nëse policia me fyen ose më keqtrajton?	7
2. Çfarë të bëj nëse kërkon diçka nga unë personi që pretendon se është nga policia?..	8
3. A më duhet të veproj sipas urdhrit apo vërejtjes së dhënë nga policia?	9
4. Çfarë lloj dhune mund të përdorë polici?	9
5. Kur ka të drejtë policia të përdorë dhunën?	11
6. A duhet polici të tregojë legjitimacionin zyrtar?	11
7. Për çfarë arsyesh policia mund të kërkojë të shohë letërnjoftimin?	14
8. A mund të më dënojë policia nëse nuk kam letërnjoftimin?	14
9. A mund të më dërgojnë në polici nëse nuk kam me vete letërnjoftimin?	15
10. Kur policia është e autorizuar të kontrollojë përmbajtjen e çantës ose makinës? ..	16
11. A mundet policia të kontrollojë çantën apo automjetin pa urdhër nga gjykata?	17
12. Çfarë të bëj nëse policia kërkon të hyjë në banesën time?	17
13. A mundet policia të bastisë banesën time pa urdhër gjyqësor?	18
14. Kur policia ka të drejtë të më arrestojë?	19
15. Cilat janë të drejtat e mia gjatë arrestimit?	20
16. A mundet policia të ma kufizojë lëvizjen pa më arrestuar?	24
17. Nëse policia më thërret për bisedë informative, a jam i detyruar të shkoj menjëherë me ta?	25
18. A duhet të jap menjëherë informata, kur policia më thërret në bisedë informative? ...	25
19. A duhet policia të japë arsyen për çfarë më thërret në bisedë informative?	26
20. Kur duhet të paraqitet tubimi publik	26
21. A kemi të drejtë për tubim spontan?	27
22. Po sikur policia të më zënë duke vozitur automjetin pa patent shoferi?	27
23. Çfarë të bëj në rast të fatkeqësisë së komunikacionit?	28
24. A guxoj të refuzoj testimin për alkool dhe drogë?	30

25. A guxoj të refuzoj testimin poligrafik?	32
26. guxoj të refuzoj testimin e ADN-së dhe marrjen e gjurmëve të gishtave?	33
27. Kujt duhet t'ia paraqes kërcënimet e marra në internet?	33
28. Kujt duhet t'ia paraqes veprën penale?	34
29. A mund të denoncoj anonimish një vepër penale?	36
30. A ka të drejtë policia të ma konfiskojë celularin apo ndonjë send tjetër dhe, nëse e merr, kur është e detyruar të ma kthejë?	37
31. Kur është policia e detyruar të më ndihmojë?	38
32. A mund të më dënojë policia nëse e pengoj ose e fyej zyrtarin e policisë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare?	39
33. A kam të drejtë t'i incizoj me celular zyrtarët e policisë?	40



* Shprehjet e përdorura në këtë doracak në gjininë gramatikore mashkullore nënkuptojnë edhe gjininë femërore të personave për të cilët flitet. Pra, fjala “polic” nënkupton edhe “police”, fjala “zyrtarë” nënkupton edhe “zyrtare” etj.

1. Kujt mund t'i ankohe me policia me fyen ose me keqtrajton?

Ju duhet të ankoheni për punën e papërshtatshme të policisë në tërësitë e mëposhtme organizative në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe/ose autoriteteve shtetërore:

1. **Drejtorisë së Policisë** – unë kuadër të MPB, duke thirrur në: **19821** ose **067/449-000** ose me e-mail në: **gradjanin.prituzbe@mup.gov.**,

2. **Sektorit për Kontrollin e Brendshëm të Policisë** – në kuadër të MPB të Brendshme, duke thirrur në: **020/247-588** ose me e-mail në: **unutrasnjakontrola@mup.gov.me.**

3. **Këshillit Etik** – të MPB-së, duke dërguar email në: **eticki.odbor@mup.gov.me.**

Ju mund të paraqitni ankesën tek këto njësi organizative brenda 30 ditësh nga dita kur mendoni se një zyrtar policie, në kryerjen e detyrave policore, u ka shkaktuar dëme ose u ka shkëlur të drejtën tuaj.¹

Është e dëshirueshme të mbani mend mbiemrin e zyrtarit të policisë ose numrin identifikues (nga distinktivi ose nga ID zyrtare), e gjithsesi, në ankesë të specifikoni sa më saktë të dhënat lidhur me kohën, vendin, veprimin ose lëshimin e bërë. Ankesa mund të jetë anonime vetëm nëse në të shprehet dyshime për ekzistimin e veprës penale (p.sh. keqtrajtimi, korrupsioni), përndryshe nuk do të merret në shqyrtim² Përgjigjen duhet ta fitoni brenda 30 ditësh nga dita kur Ministria e fiton ankesën tuaj.³

Nëse nuk jeni të kënaqur me përgjigjen, ose nëse nuk e fitoni brenda atij afati, mund të parashtroni ankesën Ministrisë të Punëve të Brendshme brenda 15 ditësh nga dita e marrjes së përgjigjes, pra, pas skadimit të afatit për përgjigje.⁴ Vendimin e ministrit do ta merrni brenda 30 ditësh nga dita e marrjes së ankesës suaj nga Ministria.⁵

E-maili për parashtrimin e ankesës Ministrisë të Punëve të Brendshme:

kabinet@mup.gov.me

4. **Këshillit për Kontrollin Qytetar të Punës së** – trupit të pavarur me seli në Parlamentin e Malit të Zi, i cili vlerëson zbatimin e kompetencave policore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, mund t'i paraqitni parashtrësë brenda gjashtë muajve nga data e ngjarjes kontestuese, në adresën: **support@kontrolapolicije.me.**⁶

1 Ligji mbi Punët e Brendshme, *Fl. zyr. MZ*, nr. 070/21, 123/21 dhe 003/23, neni 32, fq. 1.

2 Rregullorja mbi mënyrën e veprimit lidhur me ankesat për punën e zyrtarit policor, *Fl. zyr. MZ*, nr. 44/22, neni 4.

3 Ligji mbi Punët e Brendshme, *op. cit.*, neni 32, fq. 2.

4 Po aty, neni 32, fq. 5.

5 Po aty, neni 32, fq. 6.

6 Po aty, neni 191 dhe Rregullorja e Punës së Këshillit për Kontrollin Qytetar të Punës së Policisë, 9/1-12, datë 2. 3. 2012, neni 10.

5. **Mbrojtësit të së Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi (Ombudsmeni)** – mund të dërgoni ankesën për punën e zyrtarëve të policisë⁷ për shkak të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, brenda gjashtë muajve nga njohja mbi shkeljen, dhe jo më vonë se një vit nga data e shkeljes së bërë.⁸ Këtë mund ta bëni duke plotësuar formularin e thjeshtë në ueb faqe <https://www.ombudsman.co.me>, me thirrje në:

+382 20 241 642 ose me e-mail në: **ombudsman@t-com.me**.

6. **Prokurorisë shtetërore** – në njërën nga prokuroritë themelore të shtetit në Mal të Zi, mund të bëni kallëzimin penal, nëse vlerësoni se është kryer një vepër penale kundër jush ose dikujt tjetër (p.sh. keqtrajtim, , torturë, marrje me dhunë e deklaratës, shkaktim i lëndimit të lehtë ose të rëndë trupor, korrupsion).⁹

7. **Gjykatës themelore** – i parashtroni kërkesën për kompensim për dëmet e shkaktuara nga zyrtarët e Drejtorisë së Policisë.¹⁰

2. Çfarë të bëj nëse kërkon diçka nga unë personi që pretendon se është nga policia?

Nëse nuk është i veshur me uniformë, zyrtari i policisë duhet t'u prezantohet me legjitimacionin zyrtar, para se të përdorë kompetencat policore.¹¹ Polici në uniformë, me rregull, në uniformën e tij mban distinktivin e policisë me një numër identifikues, ndërkaj legjitimacionin zyrtar do ta tregojë vetëm nëse ju e kërkonti atë.¹² (Për më shumë detaje, shihni nën 6).

Zyrtari i policisë duhet të tregojë qartë arsyen se pse ju drejtohet. Për shembull, nëse ai ua kërkon t'i tregoni letërnjoftimin ose një dokument tjetër, ju keni të drejtë të pyesni për arsyen e identifikimit'. Dhe kur ju kërkohet të bëni diçka tjetër gjatë kryerjes së një detyre policore, ju keni të drejtë për shpjegim, mund të thoni atë që e vlerësoni si të rëndësishme në lidhje me të dhe të kërkonti praninë e një personi që i besoni. Mirëpo, e gjithë kjo vlen nëse rrethanat mundësojnë dhe nëse nuk rrezikojnë apo e shtyjnë kryerjen e detyrës policore.¹³

7 Ligji mbi Mbrojtësin e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Malit të Zi, *Fl. zyr. MZ*, nr. 42/11, 32/14 dhe 21/17, neni 31, fq. 1, thotë: "Ankesa duhet të përmbajë emrin e organit të cilin i është bërë, përshkrimin e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut, faktet dhe provat që e mbështesin ankesën, të dhënat mbi atë se cilat mjete juridike janë, emrin dhe adresën personale të parashtruesit, dhe shënjen nëse personi që paraqet ankesën është dakord që emri i tij ose i saj të bëhet i ditur në proces." Shih gjithashtu dhe Ligjin mbi Punët e Brendshme, *ver.cit.* neni 202.

8 Po aty, neni 32.

9 Kodi i Procedurës Penale, *Fl. zyr. MZ*, nr. 57/2009, 49/2010, 47/2014, 2/2015, 35/2015, 58/2015, 28/2018, 116/2020 dhe 145/21, neni. 256, fq. 1.

10 Ligji mbi Marrëdhëniet Obligative, *FL. zyr. MZ.*, nr. 47/08, 4/11, 22/17, neni 148 dhe 207 dhe Ligji mbi Punët e Brendshme, *ver.cit.* neni 33.

11 Ligji mbi Punët e Brendshme, *ver.cit.* neni 52.

12 Po aty, neni 52., fq. 1.

13 Po aty, neni 52. fq. 3.

Zyrtarët e policisë janë të detyruar të veprojnë me kujdes, të mos cenojnë dinjitetin dhe të mos shqetësojnë qytetarët pa nevojë, veçanërisht nëse bëhet fjalë për persona nën moshën deri 14 vjeçare, të moshuar, të sëmurë, persona me vështirësi në lëvizje, persona me invaliditet ose për gratë shtatzëna.¹⁴

3. A më duhet të veproj sipas urdhrit apo vërejtjes së dhënë nga policia?

Në parim, ju jeni të detyruar të veproni në përputhje me urdhrin ose vërejtjen e zyrtarit të policisë, dhe më pas mund të ankoheni nëse vlerësoni se u janë shkelur të drejtat tuaja (shih 14). Nuk jeni të detyruar të zbatoni urdhrin që është qartësisht i paligjshëm dhe paraqet vepër penale, p.sh. të lëndoni veten ose dikë tjetër, të shkatërroni pronën tuaj ose të dikujt tjetër, pa shkak të arsyeshem, të jepni deklaratën nën presion, etj.

Nëse kundërshtoni, veproni dhunshëm ose në ndonjë mënyrë tjetër pamundësoni kryerjen e detyrës policore, do të përballeni me pasojat e parashikuara me ligj, që mund të sjellin edhe deri te përgjegjësia penale për pengimin e zyrtarit në kryerjen e veprimit zyrtar.¹⁵ Nëse nuk reagoni në vërejtje ose urdhër, polici mund të përdorë dhunën kundër jush.¹⁶ (shiko nën 4). Gjithsesi, ai nuk guxon t'u keqtrajtojë, t'u shkaktojë lëndime të panevojshme trupore, pra ai nuk duhet të përdorë forcë të tepruar, që nuk është proporcionale me atë që është e domosdoshme në ato rrethana.¹⁷

4. Çfarë lloj dhune mund të përdorë polici?

Zyrtarët policorë janë të autorizuar që në situata të caktuara (shih nën 5) të përdorin mjetet e caktuara të dhunës,¹⁸ që mund të jenë:

– **fuqia fizike;**

– **spërkatës dore dhe paralizues elektrik (elektroshok)** – këto mjete, për shembull, polici nuk guxon t'i përdorë kur bëhet rezistencë pasive¹⁹ (p.sh. protesta duke u ulur në rrugë);

– **shkopi i gomës** – mund të përdoret nëse forca fizike dhe spërkatësi nuk ndihmojnë,²⁰ madje edhe në rast kur bëhet rezistenca pasive që nuk mund të tejkalohet në

¹⁴ Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni. 53.

¹⁵ Kodi Penal i Malit të Zi, *Fl. zyr. RMZ*, nr. 70/2003, 13/2004..., 49/2018, 3/2020, 026/21, 144/21 dhe 145/21, neni. 375.

¹⁶ Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni. 94. fq. 2 dhe 5.

¹⁷ Po aty, neni 94. fq. 4 dhe 7.

¹⁸ Po aty, neni 94. fq. 4.

¹⁹ Po aty, neni 99, fq. 1 dhe neni. 100, fq. 1.

²⁰ Po aty, neni. 101, fq. 1.

asnjë mënyrë tjetër; me shkopin e gomës nuk lejohen goditjet në kokë, në qafë dhe në gjenitale, përpos në raste ekstreme, dhe nuk guxohet të përdoret kundër grupeve të lëndueshme (gratë shtatzëna, fëmijët, të sëmurit, personat me invaliditet), përveç nëse ata, duke përdorur armë zjarri, gjegjësisht sende tjera të rrezikshme, rrezikojnë jetën e tyre, të policit ose të dikujt tjetër;²¹

– **mjetet për lidhje** (pranga, rripa plastikë),²² gjithashtu, në parim, nuk përdoren ndaj grupeve të lëndueshme; mund të përdorën gjatë prishjes së rendit dhe qetësisë publikë, kur ofroni rezistencë pasive, tentoni të sulmoni zyrtarin policor, por edhe për të parandaluar arratisjen, vetëlëndimin ose lëndimin e tjetrit;²³ është e rëndësishme të paralajmëroni policin nëse ua shtrëngon prangat tepër, në mënyrë që të parandaloni shfaqjen e lëndimeve të panevojshme fizike;

– **qeni zyrtar**, që polici mund të lëshojë drejt jush nëse tentoni të arratiseni, dhe keni kryer një veprim penal (p.sh., hajdutëri), e që ka një shportën mbrojtëse në fytyrë.²⁴ Qeni pa shportë mbrojtëse mund të përdoret nëse, për shembull, është shkelur në masë më të madhe rendi dhe qetësia publike ose për të mbrojtur jetën,²⁵ gjë që i mundëson gjithashtu përdorimin e revoles ose **armëve të tjera të zjarrit**, nëse nuk mund të arrihet qëllimi i detyrës së policisë me mjetet e tjera.²⁶

Nëse një grup prej tre a më shumë individësh nuk shpërndahej pas dhënies së urdhrit dhe sillen në mënyrë të paligjshme, nëse shkaktojnë dhunë ose dhuna tashmë ka ndodhur, p.sh. në një tubim publik ose ngjarje sportive,²⁷ policia mund të përdorë **pajisje për spërkatje me ujë**,²⁸ ndërsa mjetet për qëllime të veçanta si **bombat shokuese, bombat flash, plumbat prej gome, druri ose plastike**²⁹ etj.,³⁰ si dhe **automjetet speciale** ose **mjetet kimike**³¹ mund të përdoren vetëm me miratimin e drejtorit të Drejtorisë së Policisë.³²

21 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni 101, fq. 3 dhe 4.

22 Po aty, neni 102., fq. 5.

23 Po aty, neni. 102. fq. 1. pika 1.

24 Po aty, neni 104, fq. 2., pika 1.

25 Po aty, neni 104, fq. 3, pika 2 dhe 3.

26 Po aty, neni 113, fq. 1.

27 Po aty, neni 95, fq. 3 dhe 4.

28 Po aty, neni 110.

29 Përdorimi i projektileve kinetike goditëse, pra fishekëve të gomës (kauçukut), drurit ose plastikës nuk rekomandohet në tubimet publike, sepse është vështirë të izolohen vetëm në individë dhe ka rrezik të konsiderueshëm të dëmtimit të kalimtarëve të rastësishëm (*Resource book on the use of force and firearms in law enforcement*, United Nations, Nju Jork, 2017, faqet 94–95). Policia e Malit të Zi pretendon se nuk blen dhe nuk përdor fishekë të gomës („Gorović: Veljović pozivao policiju da skine uniforme”, portali Vijesti, 7. 9. 2021).

30 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni 95 dhe neni 112.

31 Po aty, neni 95., fq. 4 dhe neni 111

32 Po aty, neni 95., fq. 4

5. Kur ka të drejtë policia të përdorë dhunën?

Me dhunë nënkuptohen përdorimi i mjeteve të dhunës (shih nën 4), të cilat policia mund t'i përdorë nëse është e domosdoshme për: mbrojtjen e sigurisë së njerëzve, refuzimin e sulmit ose për parandalimin e arratisjes, si dhe kur me paralajmërim ose me dhënien e urdhrat nuk mund të zbatohet detyra.³³

Sipas rregullit, policia zakonisht përdor mjetet më të buta të dhunës, me të cilat arrihet qëllimi.³⁴ Para se të përdorë dhunën, është e detyruar të paralajmërojë për këtë.³⁵ Paralajmërimi nuk do të bëhet vetëm nëse ky veprim mund të rrezikonte arritjen e qëllimit të punës së policisë.³⁶

Në rast të përdorimit të dhunës, zyrtarët e policisë janë të detyruar të:

- mbrojnë jetën;
- të shkaktojnë sa më pak lëndime dhe dëme materiale;
- ofrojnë ndihmën e shpejtë ose sigurojnë ndihmën e shpejtë mjekësore;
- njoftojnë menjëherë familjen dhe të afërmit e personit të lënduar apo të rrezikuar.³⁷

6. A duhet polici të tregojë legjitimacionin zyrtar?

Kur një polic u afrohet me rroba civile, ai është i detyruar të prezantohet duke treguar legjitimacionin zyrtar.³⁸

Kur ju afrohet me uniformë, do t'ua tregojë distinktivin ose legjitimacionin zyrtar vetëm nëse ju ia kërkonit atë.³⁹ Në raste të jashtëzakonshme, ai nuk është i detyruar të identifikohet kur kjo mund të rrezikojë arritjen e qëllimit të punës policore, p.sh., nëse dyshon se do të ofroni rezistencë të dhunshme ose do të asgjësoni provat.⁴⁰ Në këtë rast, duhet t'u njoftojë me fjalën "policia", por jo edhe nëse kjo do të rrezikonte arritjen e qëllimit të punës së policisë.⁴¹

Kur zyrtarët e policisë veprojnë në pajisje speciale (të maskuar), uniformat e tyre duhet të kenë një shenjë të dukshme me shkronja e numra që mundëson identifikimin e tyre.⁴²

33 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërc.it*. neni 94, fq. 4.

34 Po aty, neni. 94, fq. 4.

35 Po aty, neni 94. fq. 5.

36 Po aty, neni 94., fq. 6

37 Po aty, neni 94, fq. 7.

38 Nësoj, neni 52. fq.1.

39 Po aty, neni 52. fq.2.

40 Po aty, neni 52. fq 3.

41 Po aty, neni 52. fq. 4 dhe 5.

42 Po aty, neni 52. fq 6.



Zyrtarët policorë dhe policët komunalë kanë disa kompetenca identike, për shembull, të dy palët mund të vërtetojnë identitetin, të kontrollojnë sendet, dhe të përdorin mjetet e dhunës (forcën fizike, spërkatësin me efekt irritimi, shkopin e gomës dhe mjetet për lidhje).⁴³

Drejtorinë e Policisë duhet dalluar nga Policia Komunale.



Drejtoria e Policisë është njësi organizative e Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila merret me mbrojtjen e sigurisë së qytetarëve dhe të drejtave dhe lirive të tyre, mbrojtjen e pronës, parandalimin e kryerjes, zbulimin dhe hetimin e veprave penale dhe të kundërvajtjes, zbulimin e autorëve të veprave penale dhe të kundërvajtjes, etj.

Policia Komunale është shërbim komunal, që kryen detyra të mbikëqyrjes komunale për të ruajtur pasuritë e qytetit – rrugët,

ndriçimin publik, vendet e parkimit publik, parqet, sipërfaqet e gjelbra, etj., dhe siguron rendin komunal duke vepruar sipas paraqitjeve, kërkesave ose sugjerimeve të qytetarëve kur ata ankohen për zhurmën në objekte hotelierike, për mosrespektimin e rregullave të shtëpisë, parkimin e parregullt, mbajtjen e parregullt të kafshëve shtëpiake dhe të tjera.

Në vijim, shihni si duket distinktivi zyrtar i policisë dhe legjitimacioni zyrtar i policisë dhe policisë komunale.

43 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër. cit.*, neni. 41 dhe Ligjit mbi Policinë Komunale, *vër. cit.*, neni. 9.

ZYRTARI POLICOR	PAMJA E DISTINKTIVIT POLICOR	PAMJA E ANËS SË JASHTME E LEGJITIMACIONIT	PAMJA E ANËS SË BRENDSHME E LEGJITIMACIONIT
			

POLICI KOMUNAL	DUKJA E KOPERTINËS SË LEGJITIMACIONIT ZYRTAR	ANA E MAJTË DHE E DJATHTË E LEGJITIMACIONIT	
	KOMUNA PODGORICË  POLICIA KOMUNALE LEGJITIMACIONI ZYRTAR	KOMUNA _____ POLICIA KOMUNALE Nr. regj. _____ Nr. serik _____ _____ (emri dhe mbiemri) _____ (titulli i policit komunal) _____ V. V. _____ (data e lëshimit) (nënshkrimi)	DETYRIMET Polici komunal, përkatësisht shefi i policisë komunale, është i autorizuar që në pajtim me Ligjin për Policinë Komunale ta paralajmërojë personin, të lëshojë urdhër, të përcaktojë identitetin, t'ia heqë lirinë bërësit të kundërvajtjes, të ndalojë dhe ta përjashtojë përkohësisht automjetin nga komunikacioni, ta bëjë kontrollin e sendeve, konfiskimin e përkohshëm të sendeve, zbatimin e mbikëqyrjen me video dhe përdorimin e mjeteve të dhunës – forcën fizike, spërkatësit të dorës me efekt irritimi, shkopit zyrtar dhe mjetet për lidhje. ^[44]

[44] Rregullore për pamjen dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar të zyrtarëve të policit komunal, Fl. zyrt. MZ, nr. 54/19.

7. Për çfarë arsyesh policia mund të kërkojë të shohë letërnjoftimin?

Zyrtari i policisë mund të kërkojë të shohë letërnjoftimin për shumë arsye, disa prej të cilave janë:

- kur hyni në objekt ose ambient të ruajtura;
- kur duhet të jeni të privuar nga liria, t'u përcjellin, t'u ndalojnë ose t'u dërgojnë tek organet kompetente;
- nëse mbi ju kryhet kontrolli ose bastisja sipas urdhrit gjyqësor (kur ekziston dyshimi se është kryer vepra penale ose kundërvajtje) ose nëse gjendeni në banesën, në hapësirat, në mjetin e transportit të dikujt tjetër, ku bëhet kontrolli ose bastisja;
- nëse gjendeni në një vend ose në një objekt ku lëvizja është e kufizuar (e ndaluar) përkohësisht;
- nëse paraqitni rrezik për personat ose për pronat e tjera, ose nëse ekziston dyshimi se paraqitni rrezik për sigurinë dhe rendin publik;
- nëse mund të jepni informacione të dobishme për kryerjen e detyrave policore p.sh., kur prej jush mblidhen informata për ndonjë vepër penal ose një kundërvajtje;
- nëse jeni të pafuqishëm dhe duhet përcaktuar identiteti juaj për t'u ofruar ndihmë;
- nëse sjellja juaj jep shkas për dyshime se jeni i mitur që ka ikur nga shtëpia ose nga institucioni arsimor, ose nëse keni humbur;
- nëse duhet vërtetuar identiteti juaj për arsye sigurie, etj.⁴⁵

8. A mund të më dënojë policia nëse nuk kam letërnjoftimin?

Nëse i keni 18 vjet, jeni të detyruar të mbani gjithmonë me vete letërnjoftimin.⁴⁶

Nëse nuk e keni me vete ose refuzoni ta tregoni, kur ua kërkojë nga polici, mund të dënoheni me para prej 60 deri në 180 €. ⁴⁷ Do t'u lëshohet urdhri për kundërvajtje dhe si zakonisht, do t'u caktohet dënimi minimal prej 60 €.⁴⁸

Udhëzimet lidhur me procedurën e kundërvajtjes: Nëse e pranoni përgjegjësinë, nënshkruajeni urdhrin për kundërvajtje në vendin e duhur dhe paguajeni dënimin.⁴⁹

Nëse nuk e pranoni përgjegjësinë, atëherë vëni nënshkrimin në urdhër në vendin ku thuhet se kërkon vendimin gjyqësor dhe ju vetë dorëzoni gjykatës këtë urdhër të nënshkruar bashkë me të gjitha provat në dispozicion, brenda tetë ditëve.⁵⁰

⁴⁵ Ligji mbi Punët e Brendshme, *Vërcit.*, neni. 70.

⁴⁶ Ligji mbi Letërnjoftimin, *FL. zyr MZ*, nr. 12/2007, 73/2010, 28/2011, 50/2012, 10/2014 dhe 18/2019, neni. 2.

⁴⁷ Po aty, neni 29.

⁴⁸ Ligji për Kundërvajtje, *FL. zyr MZ*, nr. 1/2011, 6/2011, 39/2011, 32/2014, 43/2017 dhe 51/2017, neni. 144.

⁴⁹ Po aty, neni 145, fq. 4.

⁵⁰ Po aty, neni 150.

Nëse nuk e parashtroshi kërkesën për vendim gjykatë, do të konsiderohet se keni pranuar përgjegjësinë dhe vendimi për kundërvajtje do të bëhet i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.⁵¹



9. A mund të më dërgojnë në polici nëse nuk kam me vete letërnjoftimin?

Nëse nuk keni letërnjoftim me vete, polici është i autorizuar t'u sjellë në stacionin e policisë për të verifikuar identitetin tuaj për arsye të njëjta për të cilat mund t'u legjitimojë (shih nën 7).⁵²

Në vend të letërnjoftimit, mund të tregoni patentën e shoferit, dokumentin e udhëtimit ose një dokument tjetër publik me fotografi për të verifikuar identitetin tuaj.⁵³ Identiteti juaj mund të vërtetohet edhe në bazë të deklaratës së një personi tjetër, identiteti i të cilit është vërtetuar më parë.⁵⁴ Kjo do të thotë se, nëse jeni në shoqërinë e dikujt që ka me vete letërnjoftimin, polici mund të kontrollojë identitetin tuaj te ai person. E njëjta vlen edhe nëse u legjitimon polici komunal.⁵⁵

Kur nuk mund të verifikojë identitetin tuaj, ose ka dyshime për vërtetësinë e dokumenteve, polici mund të verifikojë identitetin tuaj përmes të dhënave nga evidenca e Ministrisë, përkatësisht Drejtorisë së Policisë.⁵⁶

⁵¹ Ligji për Kundërvajtje, *vër. cit.*, neni. 148.

⁵² Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër. cit.*, neni 77.

⁵³ Po aty, neni 71, fq. 1.

⁵⁴ Po aty, neni 71, fq. 2.


⁵⁵ Rregullore për mënyrën më të afërt të kryerjes së detyrave dhe zbatimit të kompetencave të policisë komunale, *FL. zyr. MZ*, nr. 054/19, neni. 19

⁵⁶ Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër. cit.*, neni. 72

10. Kur policia është e autorizuar të kontrollojë përmbajtjen e çantës ose makinës?

Polici mund të kontrollojë mjetin e transportit, udhëtarët ose bagazhin në mënyrë vizuale, me prekje, duke përdorur pasqyrë, detektor, qen zyrtar edhe pa urdhër ose fletë urdhëresë nga eprori, si dhe pa urdhër nga gjykata, kur është e nevojshme: për mbrojtjen e sigurisë së njerëzve ose pronës; parandalimin e kryerjes së veprës penale; parandalimin e arratisjes së kryesit të veprës penale; gjetjen e armëve ose veglave; sigurimin e personave, objekteve, hapësirave; kryerjen e kontrollit doganor, gjegjësisht kur në bazë të të dhënave të disponueshme ekziston dyshimi se në mjetin e transportit të llojit të caktuar, pra tek udhëtari ose në bagazh, ndodhen persona që kërkohen, objekte ose gjurmë të veprës penale ose të kundërvajtjes, e të ngjashme.⁵⁷

Me kontrollim nënkuptohet kontrolli i të gjitha hapësirave të hapura dhe të mbyllura të automobilit ose objekteve që transportoni, pra zyrtari i policisë mund t'u kërkojë të hapni bagazhin ose çantën për të kryer kontrollin e jashtëm dhe të brendshëm.⁵⁸ Nëse refuzoni, zyrtari i policisë, mund të kërkojë urdhrin gjyqësor për kontroll ose ta bëjë këtë pa urdhër. Në vijim lexoni kur policia ka të drejtë të kontrollojë çantën ose makinën tuaj pa urdhër.



⁵⁷ Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.*, neni. 91

⁵⁸ Po aty, neni 91. fq. 5.

11. A mundet policia të kontrollojë çantën apo automjetin pa urdhër nga gjykata?

Nëse gjatë kontrollit, zyrtari i policisë konstaton ose dyshon se është kryer një vepër penale që ndiqet zyrtarisht (vrasje, vjedhje, hajdutëri, prodhim, , mbajtje dhe shpërndarje e paligjshme e drogave...) ai mund ta kontrollojë automjetin ose çantën tuaj pa urdhër gjyqësor.⁵⁹ Kjo do të thotë jo vetëm se do ta shikojë automjetin nga jashtë dhe brenda, por do ta kontrollojë duke çmontuar pjesët të caktuara, gjegjësisht jo vetëm se do të prekë apo shikojë çantën, por edhe do të fusë dorën brenda saj, t'i nxjerrë të gjitha gjërat nga ajo dhe do t'i kontrollojë një nga një. ⁶⁰ Kur e bën këtë lloj kontrolli pa urdhër gjyqësor, zyrtari i policisë është i detyruar që menjëherë t'i japë raport gjykatësit hetues. Në rast se në çantën ose automjetin tuaj gjendet celulari, kompjuteri, USB dhe pajisje të ngjashme, ta keni nëndërmend se për të kryer kontrollin e tyre urdhri gjyqësor është i domosdoshëm.⁶¹

Përveç kësaj, pa urdhër gjyqësor, policia mund të kryejë bastisjen e secilit person qepër të cilin, gjatë kryerjes së urdhrit për përcjellje ose heqje të lirisë, dyshohet se posedon armë ose vegël për sulm, ose se ky person do të fshehë ose do t'i asgjësojë objektet që duhet t'i merren dhe të shërbejnë si prova në procesin penal.⁶²

12. Çfarë të bëj nëse policia kërkon të hyjë në banesën time?

Policia mund të kërkojnë të hyjnë në banesën tuaj kur ekziston dyshimi se do të gjejë personin e akuzuar për vepër penale, apo për gjurmë ose sende që lidhen me kryerjen e veprës penale.⁶³ Nëse kanë një urdhër kontrolli, atë do t'u dorëzojë dhe do t'ju ftojë të dorëzoni vullnetarisht sendet e kërkuara ose të dyshuarin që e fshihni.⁶⁴ Ju keni të drejtë të thirrni avokatin, kështu që kontrolli do të shtyhet derisa ai të vijë, më së shumti për dy orë.⁶⁵ Nën 13, lexojeni kur policia ka të drejtë të hyjë në banesën tuaj pa urdhër kontrolli që e lëshon gjykata.

Policia do t'u kërkojë të hapni hapësirat, mobilet ose objektet e tjera të mbyllura, e nëse refuzoni, ata do t'i hapin me forcë duke u përpjekur që të shkaktojnë sa më pak

⁵⁹ Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni. 83, fq. 6.

⁶⁰ Ligji për Kontrollin Kufitar, *FL. zyr MZ.*, nr. 72/2009, 20/2011, 40/2011, 39/2013, 17/2019, 146/21, 125/23, Art. 32

⁶¹ Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 75, fq. 2 dhe neni 83, fq. 6.

⁶² Po aty, neni 83.

⁶³ Po aty, neni 75. fq. 1.

⁶⁴ Po aty, neni 80. fq. 1.

⁶⁵ Po aty.

dëme.⁶⁶ Ju e nënshkruani procesverbalin e bastisjes, dhe nëse u janë marrë objekte ose dokumente, për këtë do të merrni një vërtetim.⁶⁷

13. A mundet policia të bastisë banesën time pa urdhër gjyqësor?

Është rregull që askush nuk mund t'u hyjë në banesë kundër vullnetit tuaj dhe të bëjë bastisjen pa vendimin gjyqësor dhe pa praninë e dy dëshmitarëve.⁶⁸ Megjithatë, ky rregull ka disa përjashtime.

Policia mund të hyjë në banesë dhe të kryejnë bastisjen edhe pa urdhër gjyqësor nëse është domosdoshmërisht urgjent reagimi për të parandaluar kryerjen e një veprë penale, për të kapur kryesin e veprës penale, për të shpëtuar njerëzit ose pronën (për shembull, në rast zjarri, përmbytjeje, kërcënim me shpërthim të bombës ose materieve të tjera të rrezikshme, kur në banesë ndodhet personi që potencialisht mund të jetë i rrezikshëm për të tjerët, e të ngjashme.), nëse vetë bartësi i banesës e kërkon këtë, nëse dikush brenda banesë kërkon ndihmë, nëse është e domosdoshme për të zbatuar një vendim për paraburgim, për marrjen e të akuzuarit ose të një personi tjetër (për shembull, i akuzuari apo dëshmitari u shmangen thirrjeve për gjykim), kur duhet t'i merret liria kryerësit të veprës penale që është në arratisje ose për të cilin është shpallur urdhër arresti.⁶⁹ Policia mund të kryejë bastisjen e banesës edhe pa praninë e dy dëshmitarëve, nëse kjo do t'i çonte ata në rrezik nga lëndimet fizike, ose nëse prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë, dhe ekziston rreziku i shtyrjes, me ç' rast, arsyet konkrete duhet t'i shënojë në procesverbalin e bastisjes të kryer.⁷⁰

Kur policia hyn në banesë pa urdhër, do t'ua japë vërtetimin ku do të shënohen arsyet e hyrjes në banesë, e ju keni të drejtë të jepni vërejtje që do të futen në vërtetimin për hyrje në banesë, gjegjësisht në procesverbalin e bastisjes së banesës.⁷¹

66 Po aty, neni 81. fq.1

67 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 81, fq. 8 dhe 9.

68 Kushtetuta e Malit të Zi, *FL. zyr. MZ*, nr. 1/2007 dhe 38/2013, neni 41.

69 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.* neni 83, fq. 1.

70 Po aty, neni 83.

71 Po aty, neni 83, fq. 2 dhe 3.

14. Kur policia ka të drejtë të më arrestojë?

Arrestimi është shprehje joformale për situatën në të cilën policia ia heq lirinë një personi.⁷²

Policia mundet në mënyrë autonome, ose me urdhër të prokurorit shtetëror ose të gjykatës, të arrestojë personin që dyshohet se ka kryer veprë penale⁷³ ose kundërvajtje⁷⁴, në këto raste:

- 1) nëse ky person fshihet ose nuk mund të përcaktohet identiteti i tij, ose nëse ekzistojnë rrethana që tregojnë rrezikun se mund të arratiset;
- 2) nëse ekzistojnë rrethana që tregojnë se ai do të asgjësojë, modifikojë, fshehë ose falsifikojë provat ose gjurmët e veprës penale ose kundërvajtës, ose do të pengojë procesin duke ndikuar në dëshmitarët, bashkëpunëtorët ose fshehësit e tij;
- 3) nëse ekzistojnë rrethana që tregojnë se ai do të përsërisë veprën penale ose kundërvajtjen, ose do të përfundojë veprimin e tentuar ose do të kryejë veprimin me të cilin kërcënon;
- 4) nëse personi dyshohet për veprë penale për të cilën mund të shprehet dënimi me burgim më së paku 10 vjet, e që është posaçërisht e rëndë për shkak të mënyrës së kryerjes ose pasojave të saj, dhe vlerësohet se heqja e lirisë është e domosdoshme për zhvillimin pa pengesa për zhvillimin e procedurës penale;
- 5) nëse personi i ftuar në mënyrë të rregullt anashkalon paraqitjen në gjyq.

E drejta në lirinë fizike është e drejtë njerëzore, e mbrojtur me Kushtetutën e Malit të Zi, kontratat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe ligjet. Kjo do të thotë se policia nuk ka të drejtë të arrestojë dikë arbitrarisht, por vetëm nëse ekzistojnë rrethana objektive për të cilat ekziston dyshimi i bazuar, se personi ka kryer veprën penale apo kundërvajtjen, dhe se të paktën disa prej rrethanave të shënuara më lart(1–5) justifikojnë heqjen e lirisë.⁷⁵

Edhe heqja më e shkurtër e paarsyeshme e lirisë është shkelje e të drejtave,⁷⁶ e cila tërheq përgjegjësinë e organit shtetëror për kompensimin e dëmeve për shkak të shkeljes së të drejtave të personit.⁷⁷

⁷² Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.* neni 264.

⁷³ Po aty, neni 264 dhe neni 175

⁷⁴ Ligji për Kundërvajtje, *Fl. zyr. MZ*, nr. 1/2011, 6/2011 – korrigjuar, 39/2011, 32/2014, 43/2017 – vendim Gjykatës Kushtetuese dhe 51/2017, nen. 166

⁷⁵ Shih p.sh. aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Asanoviç kundër Malit të Zi*, nr. 52415/18, 2021, fq. 97.

⁷⁶ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut konstatoi se vetëm 45 minuta ndalim të pajustificuar në stacionin policor është shkelje e së drejtës për liri (Aktgjykimi *Shimovolos kundër Rusisë*, Nr. 30194/09, fq. 50, 2011), pra në një rast tjetër rreth një orë e gjysmë ndalim në makinë policie (aktgjykimi *Zelčs v. Letonia*, nr. 65367/16, fq. 40–41).

⁷⁷ Ligji për Marrëdhëniet Obligative, *vër.cit.*, neni. 148, 207, 210a

15. Cilat janë të drejtat e mia gjatë arrestimit?



Policia është e detyruar të njoftojë personin të cilit ia heq lirinë, mbi:

a) arsyet e heqjes së lirisë, në gjuhën e tij ose në një gjuhë tjetër që ai e kupton;⁷⁸

b) të drejtën e tij të mos deklarojë asgjë dhe as të përgjigjet në pyetje;⁷⁹

c) të drejtën që për heqjen e lirisë të informohet menjëherë personi sipas zgjedhjes së tij (si dhe përfaqësuesi diplomatik-konsullor i shtetit, shtetas i të cilit është, ose përfaqësuesi e organizatës ndërkombëtare, p.sh. KB, nëse është fjala për person pa shtetësi ose refugjat);⁸⁰

d) të drejtën për mbrojtës (avokat) sipas zgjedhjes së tij;⁸¹

e) të drejtën për kontrollin mjekësor në polici, nga një doktor i mjekësisë, sipas zgjedhjes së tij,⁸² ndërsa kur personi të sillet para prokurorit shtetëror, kontrollin mund të kërkojë edhe avokati i tij, një anëtar i familjes ose partneri jashtëmartesor.⁸³

Nëse personi që privohet nga liria është përkujdesur vet për fëmijë ose për anëtar tjetër të familjes, që ka nevojë për përkujdesje, policia, për privimin nga liria do të informojë organin kompetent të përkujdesjes sociale.⁸⁴

78 Kodi i Procedurës Penale, neni 5, fq. 1.

79 Po aty, neni 5, fq. 1, neni 261, fq. 2.

80 Po aty, neni 5 dhe neni 180.

81 Po aty, neni 5, fq. 1, neni 261, fq. 3.3

82 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni 79, fq. 1.

83 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 268, fq. 6

84 Po aty, neni 5, fq. 1, neni 180, fq. 1.

Policia, për privimin nga lirisë, duhet të njoftojë menjëherë prokurorin e shtetit, të përpilojë procesverbalin zyrtar që përmban kohën dhe vendin e heqjes të lirisë dhe të dërgojë *pa vonesë* personin te prokurori shtetëror, më së voni brenda 24 orësh.⁸⁵ Nëse ky afat tejkalohet, policia është e detyruar ta lirojë menjëherë personin e arrestuar.⁸⁶ Personin e arrestuar për kundërvajtje, policia gjithashtu e dërgon *menjëherë* në gjykatën për kundërvajtje, më së voni brenda 12 orësh.⁸⁷

Pasi respektimi i këtyre afateve është i obligueshëm, është shumë e rëndësishme që koha e heqjes së lirisë të përcaktohet me saktësi. Për përmbajtjen e procesverbalit policor lidhur me këtë, nuk është paraparë ankesë e veçantë, por gjithsesi kjo mund të kundërshtohet para gjykatës me ankesën *habeas corpus*⁸⁸ ose me padi për heqjen e lirisë pa bazë.

Zyrtari i policisë paralajmëron të arrestuarin se do të përdorë armë zjarri nëse ai tenton të arratiset ose ta sulmojë.⁸⁹

Kur personi është nga privuar liria, kjo do të thotë se është dyshuar ose tashmë është akuzuar se ka kryer një vepër penale ose kundërvajtje.⁹⁰ Atë, si të dyshuar ose të akuzuar, e merr në pyetje prokurori i shtetit, por mund ta marrë në pyetje edhe policia, kur për këtë e autorizon prokurori i shtetit. Çdo deklaratë e dhënë në këtë cilësi konsiderohet si provë në procedurën penale, nga e cila shpesh varet vendimi për përgjegjësinë penale. Për këtë arsye, rekomandohet që marrja në pyetje të bëhet gjithmonë në praninë e avokatit.

Nëse policia merr në pyetje personin e privuar nga liria, në këtë marrje në pyetje avokati duhet të jetë i pranishëm.⁹¹ Mirëpo, qytetari shpesh është i ftuar në stacionin e

85 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.* neni 264, fq. 1

86 Po aty, neni 264, fq. 3.

87 Ligji për Kundërvajtje, *vërcit.* neni 166.

88 Kushdo i privuar nga liria ka të drejtën e këtij apeli bazuar në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 9, fq. 4 dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni. 5 fq. 4

89 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.* neni 94 dhe 113.

90 **I dyshuari** është personi ndaj të cilit organi kompetent shtetëror ka ndërmarrë masa për shkak të pranisë së dyshimit të bazuar se ka kryer një veprë penale, dhe për të cilin ende nuk është dhënë urdhri për kryerjen e hetimit, dhe nuk është dorëzuar akuzë e drejtpërdrejtë; **i akuzuar** është personi kundër të cilit është dhënë urdhri për kryerjen e hetimit ose kundër të cilit është paraqitur akuzë e drejtpërdrejtë, propozimi i akuzës ose padia private ose personi kundër të cilit është iniciuar procedura e posaçme për zbatimin e masave të sigurisë, trajtimi psikiatrik i detyrueshëm dhe ruajtja në institucion shëndetësor dhe trajtimi psikiatrik i detyrueshëm në liri; termi "i akuzuar" mund të përdoret në procedurën penale si një emër i përgjithshëm për të akuzuarin, të akuzuarin dhe të dënuarin (Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 22). I akuzuari është gjithashtu personi kundër të cilit po zhvillohet një procedurë për kundërvajtje (Ligji për Kundërvajtje, *vërcit.*, neni 112, fq. 1).

91 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 69, fq. 5 dhe neni 261, fq. 5.

policisë për bisedë informative (ku prania e avokatit nuk është e detyrueshme) lidhur me ndonjë ngjarje, e gjatë kësaj bisede policia vlerëson se ai duhet jetë i dyshuar. Prandaj është e rëndësishme të dini se gjatë bisedës informative në polici *mund të vini me avokat* dhe se prania e tij në këtë bisedë informative duhet të jetë e mundësuar.⁹² Prania e avokatit zvogëlon rrezikun marrjes me dhunë e deklaratës dhe i kontribuon ndjenjës së sigurisë.

Në momentin kur zyrtarët e policisë gjatë bisedës informative vlerësojnë se personi i marrë në pyetje mund të bëhet i dyshuar, ata janë të detyruar të njoftojnë menjëherë prokurorin e shtetit, i cili, do të kërkojë nga policia që ta sjellë personin në zyrat e prokurorisë nëse marrja në pyetje është e domosdoshme para fillimit të hetimit.⁹³



92 Po aty, neni 259, fq. 1 dhe 4.

93 Po aty, neni 261, fq. 1.

Kur vini te prokurori i shtetit, dhe u kanë privuar nga liria, ai do t'ju njoftojë se keni të drejtë në mbrojtës (avokat). Avokatin mund ta thërrisni vetë ose të bini në kontakt me të përmes ndonjë anëtare të familjes ose të një personi tjetër, identiteti i të cilit duhet t'i komunikohet prokurorit, e nëse është e nevojshme, prokurori mund t'ju ndihmojë në angazhimin e ti.⁹⁴

Megjithatë, nëse vendosni të mos e angazhoni avokatin në afat prej 12 orësh pasi të jeni njoftuar që keni të drejtë ta bëni këtë, ose deklaroni se nuk keni nevojë për të (e nuk bëhet fjalë për mbrojtje të detyrueshme), prokurori do t'u marrë në pyetje pa prezencën e avokatit, më së voni brenda 12 orësh.⁹⁵

Nëse mbrojtja gjatë marrjes në pyetje para prokurorit të shtetit është e detyrueshme (për personat invaliditeti i të cilëve ua vështirëson mbrojtjen e suksesshme, si dhe për personat për të cilët zhvillohet procedura për veprë penale për të cilën mund të shprehet dënimi maksimal me burgim⁹⁶), e ju nuk dëshironi të angazhoni avokatin, ai do t'u caktohet sipas detyrës zyrtare, sipas radhës alfabetike të mbiemrave në listën e Odës së Avokatëve.⁹⁷

Për marrjen në pyetje, përpilohet procesverbali, në të cilin mund të shtohen vërejtjet.⁹⁸

Pas marrjes në pyetje prokurori do t'u lënë në liri, përveç nëse vlerëson se ka arsye për ndalimin tuaj⁹⁹ – (për shembull, rrezik i asgjësimit të provave, i arratisjes, përsëritjes së veprës penale ose nëse paraburgimi është i nevojshëm për zhvillimin pa pengesa të procedurës, e bëhet fjalë për një vepra penale për të cilën mund të shprehet dënimi me burgim prej dhjetë vjetësh ose më shumë i rëndë).¹⁰⁰ – kur mund të sjell urdhrin për ndalim për më së gjati 72 orësh nga momenti i heqjes së lirisë.¹⁰¹ Çdo person i mbajtur, nga momenti i sjelljes së vendimit duhet të ketë mbrojtësin.¹⁰² Kundër vendimit për ndalim, ekziston e drejta e ankesës. Gjykatësi hetues vendos për ankesën urgjentisht, brenda katër orësh.¹⁰³

94 Po aty, neni 266, fq. 1.

95 Kodi i Procedurës Penale, *op. cit.*, neni 266, fq. 2.

96 Po aty, neni 69, fq. 1.

97 Po aty, neni 266, fq. 3.

98 Po aty, neni 261, fq. 8.

99 Po aty, neni 266, fq. 4.

100 Po aty, neni, fq. 1

101 Po aty, neni 267.

102 Po aty, neni 69, fq. 6.

103 Po aty, neni 267.

16. A mundet polica të ma kufizojë lëvizjen pa më arrestuar?

Policia ka të drejtë të kufizojë përkohësisht lëvizjen në një hapësirë - më së shumti për 12 orë¹⁰⁴ – ose hyrjen në një objekt ose daljen nga objekti –më së shumti për 6 orë¹⁰⁵ – nëse:

- largon rrezikun për njerëzit ose pasurinë (p.sh. në rastin e minimi të objektit, rrezimit të gurëve, rrëshqitjes së truallit, njoftimit për vendosjen e bombës, etj.);
- parandalon kryerjen e veprës penale ose kundërvajtjes;¹⁰⁶
- përpiket të gjejë ose kapë autorin e veprës penale ose të kundërvajtjes;¹⁰⁷
- kërkon prova për kryerjen e veprës penale, për të cilën ndiqet zyrtarisht - si vjedhja, hajdutëria, sjellja e dhunshme etj. - ose kundërvajtje për të cilën është paraparë dënim me burgim¹⁰⁸ (për shembull, për fyerje dhe sjellje arrogante, nxitje ose provokimi të një konflikti, përdorimi i armës së zjarrit pa leje në vendin publik, etj.);¹⁰⁹
- siguron personin e mbrojtur, hapësirën e mbrojtur;¹¹⁰
- bllokon rrugët, bën bastisje, vë kurthe etj. për nevojat e operacioneve policore;¹¹¹
- është e domosdoshme për të kryer identifikimin e dikujt ose për të kryer kontrollin kufitar.¹¹²

Policia mund ta ndalojë në vendin e ngjarjes personin e gjetur në vendin e veprës penale deri në ardhjen e prokurorit të shtetit, nëse vlerëson se personi mund të ofrojë të dhëna të rëndësishme për procedurën penale.¹¹³ Ky ndalim mund të zgjasë më së shumti 6 orë.¹¹⁴

104 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër. cit.*, neni 80, fq. 2.

105 Po aty, neni 80, fq. 3.

106 Po aty, neni 80, fq. 1.

107 Po aty.

108 Po aty.

109 Ligji për rendin dhe paqen publike, *FL. zyr. MZ*, nr. 64/11 dhe 56/20, neni. 7, neni. 10 dhe neni. 13

110 Ligji për Punët e Brendshme, *vër.cit.*, neni 80.

111 Po aty, neni 81.

112 Ligji për kontrollin kufitar, *vër.cit.*, neni. 31.

113 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 258. fq.1

114 Po aty.

17. Nëse policia më thërret për bisedë informative, a jam i detyruar të shkoj menjëherë me ta?

Ju mund të detyroheni të shkoni për bisedë informative vetëm nëse nuk i jeni përgjigjur thirrjes, madje vetëm nëse u është tërhequr vërejtja lidhur me këtë në thirrje.¹¹⁵ Në thirrje përcaktohet dita dhe ora kur duhet të jeni në zyrat e policisë me qëllim të mbledhjes së informatave të duhura. Megjithatë, ndonjëherë në vend të kësaj, në thirrje mund të shkruhet se duhet të përgjigjeni “menjëherë”. Qëndrimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin *Asanović kundër Malit të Zi* është se një shprehje e tillë nuk duhet të përdoret, pasi me të privohet mundësia juaj për të vendosur vetë për thirrjen e marrë dhe për t’u pajtuar me të me vullnetin tuaj, në kundërshtim me Kodin e Procedurës Penale dhe të drejtën për liri dhe siguri.¹¹⁶

18. A duhet të jap menjëherë informata, kur policia më thërret në bisedë informative?

Biseda informative mund të zgjasë aq sa është e nevojshme për t’u fituar informatat e duhura nga qytetari, e më së shumti gjashtë orë.¹¹⁷ Nëse nuk dëshironi të jepni informata ose nuk i keni ato, ky afat nuk zbatohet për ju dhe duhet të liroheni menjëherë nga policia.¹¹⁸

Policia gjatë bisedës informative nuk duhet t’u marrë në pyetje si të akuzuar, dëshmitar ose ekspert.¹¹⁹ Megjithatë, nëse gjatë bisedës lind dyshimi i bazuar në ju, policia mund t’u privojë nga liria. Ajo është e detyruar të njoftojë menjëherë prokurorin, të bëjë shënimin zyrtar që përmban kohën dhe vendndodhjen e saktë të privimit nga liria, dhe t’ju sjellë te prokurori menjëherë, e më së voni brenda 24 orësh (shih më shumë në përgjigjen nën 14).

Është thelbësore të dini se keni të drejtë të shkoni në zyrat e policisë me avokat dhe se policia është e detyruar të lejojë praninë e tij gjatë marrjes së informacionit nga ju.¹²⁰

115 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 259, fq. 1.

116 *Asanović kundër Malit të Zi* (kërkesa nr. 52415/18)

117 ZKodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni. 259, fq. 2

118 Po aty, neni 259, fq. 3

119 Po aty, neni 259, fq.7

120 Po aty, neni 259, fq. 4.

19. A duhet policia të japë arsye për çfarë më thërret në bisedë informative?

Policia në thirrje duhet të shënojë arsyen përse ju thërret për bisedë informative.¹²¹ Me rregull, kjo bëhet për të mbledhur informacione lidhur me një vepër të kryer penale, ose me autorin e saj. Kini parasysh se nëse jeni marrë në pyetje për të njëjtën çështje, për bisedë të përsëritur mund të thirrreni vetëm me pëlqimin e prokurorit.¹²²

20. Kur duhet të paraqitet tubimi publik?

Tubimin publik duhet ta paraqitni nëse planifikoni tubim të më shumë se 20 personave.¹²³ Po ashtu edhe përfaqësuesit e mediave duhet llogaritur në numrin e të tubuarve, nëse i ftoni në tubim. Kërkesa me shkrim për tubimin duhet të dorëzohet më se voni pesë ditë para mbajtjes së tubimit.¹²⁴



121 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 259, fq. 1

122 Po aty, neni 259, fq. 6

123 Ligji për Tubimet Publike dhe Manifestimet Publike, *Fl. zyr. MZ*, nr. 52/2016, neni 2

124 Po aty, neni 10.

Paraqitjen ia dërgoni policisë në vendin ku planifikoni të mbani tubimin.¹²⁵ Kërkesa duhet të përmbajë informatat për organizatorin, hapësirën, datën dhe orën e tubimit, programin dhe qëllimin e tubimit, si dhe vlerësimin e numrit të pjesëmarrësve.¹²⁶

Keni parasysh se e drejta e vetme e mbrojtur është e drejta për tubim paqësor, pra për tubim pa përdorim të dhunës.¹²⁷ Kur ekziston rreziku se tubimi nuk do të jetë i qetë, policia mund ta incizojë atë.¹²⁸ Për këtë qëllim, duhet të njoftojë opinionin jo më vonë se 24 orë para fillimit të incizimit.¹²⁹

21. A kemi të drejtë për tubim spontan?

Po. Tubimi spontan është tubim i më shumë se 20 personave, të cilët reagojnë spontanisht ndaj një ngjarjeje që nuk mund të parashihej dhe për këtë arsye pranohet se tubimi nuk ka mundur të paraqitet me kohë në pajtim me ligjin. Sipas standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në parim, shteti është i detyruar të mundësojë tubimet spontane, d.m.th. të mos i ndërpresë të paktën derisa pjesëmarrësit ta shprehin porosinë për të cilën janë mbledhur, me kusht që tubimi të jetë paqësor.¹³⁰ Sipas Ligjit mbi Tubimet Publike, zyrtari policor është i autorizuar t'u tregojë pjesëmarrësve të tubimit spontan se tubimi nuk është organizuar në pajtim me ligjin dhe t'i paralajmërojë ata se janë të obliguar të respektojnë ligjin.¹³¹ Duke pasur parasysh standardet evropiane, policia duhet të jetë tolerante ndaj tubimeve spontane.

22. Po sikur policia të më zënë duke vozitur automjetin pa patent shoferi?

Zyrtari i policisë do t'ju përjashtojë përkohësisht nga komunikacioni nëse:

- nuk keni me vete patentin e shoferit;¹³²
- drejtoni një kategori të caktuar të makinës, por nuk keni me vete patentën e sho-

125 Drejtorisë së sigurisë (DS) Podgoricë, DP Danillovgrad, DS Cetinë, DP Nikshiq, DP Plevle, DS Tuz, DS Bijello Pole, DS Berane, DS Mojkovc, DS Kollashin, DS Plavë, DS Rozhajë, DS Tivar, DS Ulqin, DS Budva, DS Herceg Novi, DS Kotor, DS Tivat, Stacioni i policisë (SP) Andrijević, SP Petnjicë, SP Guci, SP Zhablak, SP Shavnik, SP Pluzhine.

126 Ligji për Tubimet Publike dhe Manifestimet Publike, *vër.cit.*, neni 11

127 Shih doracakun "Liria e tubimit paqësor në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut", Aksioni për të Drejtat e Njeriut dhe Instituti Alternativ, Podgoricë, Prill, 2020.

128 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër.cit.*, neni. 93

129 Po aty.

130 *Ataman kundër Turqisë*, kërkesa nr. 74552/01, datë 5 dhjetor 2006

131 Ligji për tubimet publike dhe manifestimet publike, *vër.cit.*, neni 13

132 Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, *FL. zyr. MZ*, nr. 33/2012, 58/2014, 14/2017, 66/2019, neni 290, fq. 1, pika 6.

ferit që ju jep të drejtën për të drejtuar atë mjet;¹³³

- afati i vlefshmërisë i patentës tuaj ka skaduar;¹³⁴
- me vete e keni patentën e cila është e dëmtuar, kështu që nga përmbajtja e saj nuk mund të verifikohet nëse keni të drejtën për të drejtuar atë mjet.¹³⁵


Do të dënoheni për kundërvajtje me të holla prej 60 deri në 200 € nëse nuk keni patent të vlefshëm shoferi me vete ose nuk ia jepni në shikim zyrtarit të policisë.¹³⁶ Do t'ju jepet menjëherë një urdhër kundërvajtjeje për të cilin është përcaktuar gjoba minimale prej 60 €¹³⁷ (shih detajet nën 3).

Në rast se drejtoni pa dhënë provimin për shofer, do të dënoheni me gjobë në të holla prej 300 deri në 600€.¹³⁸

23. Çfarë të bëj në rast të fatkeqësisë së komunikacionit?

"Fatkeqësia e komunikacionit është ngjarje që ka ndodhur në rrugë, ose ka filluar në rrugë, në të cilën përfshihet të paktën një mjet në lëvizje dhe në të cilën janë lënduar ose kanë vdekur një ose më shumë persona, gjegjësisht kanë vdekur brenda 30 ditësh nga pasojat e kësaj fatkeqësie të komunikacionit, ose është shkaktuar dëm material."¹³⁹

Nëse jeni pjesëmarrës në fatkeqësi të komunikacionit ose thjesht ndodheni në vendin e fatkeqësisë ku ka të lënduar, ju jeni të obliguar të njoftoni menjëherë policinë dhe shërbimin e ndihmës së shpejtë mjekësore, të ndihmoni të lënduarit sipas aftësive tuaja dhe, në rast nevojë, t'i transportoni ata në institucionin më të afërt shëndetësor.¹⁴⁰



133 Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor, *vër.cit.*, neni 290, fq. 1, pika 6

134 Po aty.

135 Po aty.

136 Po aty, neni 323, fq. 1, pika 28.

137 Ligji për Kundërvajtje, *vër.cit.*, neni 144

138 Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor, *vër.cit.*, neni 319, fq. 5

139 Po aty, neni 7.

140 Ligji për sigurinë në komunikacionin rrugor, *vër.cit.*, neni 165

Nëse jeni pjesëmarrës i fatkeqësisë së komunikacionit ku ka vetëm dëme materiale, jeni të obliguar të:

- largoni pengesat nga rruga, dhe në qoftë se nuk e arrini këtë, menjëherë duhet t'i paralajmëroni shoferët e tjerë për to;
- largoni mjetin tuaj dhe ta leni në anën e rrugës në qoftë se e pamundëson qarkullimin;
- Paralajmëroni të gjithë të largohen nga rruga për të mos penguar trafikun;
- Leni të dhënat tuaja dhe të mjetit tuaj tek shoferi i mjetit të dëmtuar, ose tek policia. Nëse shoferi mungon (p.sh. bëhet fjalë për automjet të parkuar), për aksidentin duhet të informoni policinë dhe t'ua jepni të dhënat tuaja personale dhe të dhënat e mjetit të dëmtuar;
- Nëse policia nuk bën raport zyrtar, plotësojeni raportin evropian mbi fatkeqësinë e komunikacionit që e merrni nga shoqëria e sigurimeve.¹⁴¹

Policia është e obliguar të shkojë në vendndodhje dhe të bëjë hetimin nëse kjo kërkohet nga njëri nga pjesëmarrësit në aksident ose nga personat që u janë shkaktuar dëme materiale.¹⁴² Nëse ju keni kërkuar hetimin, do të mbuloni shpenzimet në vlerë prej 50€. ¹⁴³ Nëse me vendimin e plotfuqishëm konstatohet se ju nuk jeni përgjegjës për aksidentin, por është një pjesëmarrës tjetër, keni të drejtë të kërkonit kompensimin e këtyre shpenzimeve nga ai.¹⁴⁴

Polici do t'u nënshtrojë testit të alkoolit, testit të drogës dhe të ngjashme.¹⁴⁵ Nëse prezenca e substancave të ndaluara u konstatohet në këtë mënyrë, e ju e mohoni këtë ose refuzoni të nënshkruani procesverbalin e testimit për alkool ose të një lloj testimi tjetër, zyrtari policor do të vendosë që t'u merret gjaku ose urina për analizë.¹⁴⁶

Nëse jeni pjesëmarrës i një fatkeqësie ku ka pasur *lëndime ose vdekje të ndonjë personi, ose është shkaktuar dëm më i madh material*, atëherë edhe obligimet tuaja janë më të mëdha: E ndaloni mjetin, fikni motorin, ndizni të katër sinjalizuesit, vendosni trekëndëshin e sigurisë, informoni policinë dhe ndihmën e shpejtë, ofroni ndihmën e parë të lënduarve sipas dijes dhe mundësive tuaja, paralajmëroni të gjithë që të largohen për të mos asgjësuar shenjat e aksidentit, prisni policinë dhe qëndroni aty deri në përfundimin e hetimit.¹⁴⁷

Policia do të kryejë hetimet dhe do të përpilojë procesverbalin.¹⁴⁸ Zyrtari i policisë do të vendosë që të gjithë pjesëmarrësve në aksident, jo vetëm drejtuesve të automje-

141 Po aty, neni 170. (Shih gjithashtu veprën penale të Mosdhënies së Ndihmës neni 157 i KPMZ).

142 Po aty, neni 169, fq. 1

143 Po aty, neni 169, fq. 2.

144 Po aty, neni 169, fq. 3.

145 Po aty, neni 172, fq. 3

146 Po aty, neni 172, fq. 4

147 Po aty, neni 166.

148 Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, *vër.cit.*, neni 168.

teve, t'u bëhet analiza e gjakut dhe urinës.¹⁴⁹ Personat që refuzojnë marrjen e gjakut dhe/ose urinës, zyrtari i policisë mund t'i çojë me detyrim në një institucion shëndetësor, ku ata janë të detyruar t'i nënshtrohen marrjes së mostrës së tillë, përveç nëse kjo do të dëmtonte shëndetin e tyre.¹⁵⁰ Në këtë rast, veprimet mjekësore do të kryhen me urdhër paraprakisht të marrë nga gjykata.¹⁵¹ Urdhri nga gjykata nuk kërkohet gjithmonë, por vetëm kur refuzoni të jepni mostrat për analizë. Policia do të mbikëqyrë marrjen e mostrave. Në rastin kur, për shkak të gjendjes shëndetësore, nuk mund të bëhet ekzaminimi i plotë, do të kryhet ajo që është e mundur.¹⁵² Institucioni shëndetësor jep mendimin dhe raportin, ndërsa gjaku dhe urina dorëzohen te zyrtari i policisë që i çon ato në laboratorin më të afërt, ku analiza mund të kryhet.¹⁵³ Laboratori jep një raport të shkruar brenda tri ditësh.¹⁵⁴ Personi te i cili zbulohet prania e alkoolit duhet të mbulojnë shpenzimet e ekzaminimit.¹⁵⁵

24. A guxoj të refuzoj testimin për alkool dhe drogë?

Jo. Si pjesëmarrës në trafik, jeni të obliguar të veproni pa humbur kohë sipas urdhrit të zyrtarit policor dhe të lejoni t'u testojnë për alkool, drogë dhe substancat e tjera psikoaktive.¹⁵⁶ Në të kundërtën, ai do t'u largojë nga trafiku, do t'u privojë nga liria¹⁵⁷ dhe mund të dënoheni për kundërvajtje me dënim burgimi prej 15 deri në 60 ditë, përveç dënimit do t'u vendosë edhe tri pika penale dhe do t'ua përcaktojë masën mbrojtëse të ndalimit të drejtimin e automjetit për një periudhë prej katër deri në gjashtë muaj.¹⁵⁸

Shoferi nën ndikimin e drogës, substancave tjera psikoaktive ose alkoolit nuk duhet të drejtojë mjetin në komunikacionin rrugor. Po ashtu, kjo vlen edhe për atë që është në gjendje shumë të lodhur, i sëmurë, gjegjësisht është në gjendje të tillë psikofizike që është i paaftë për drejtimin e sigurt të mjetit.¹⁵⁹

Shoferët nën moshën 24 vjeçare dhe ata me më pak se 12 muaj përvojë drejtimi nuk duhet të drejtojnë mjetin e motorizuar nëse kanë alkool në organizëm në cilëndo sasi.¹⁶⁰

149 Po aty, neni 172.

150 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 154

151 Po aty.

152 Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, *vër.cit.*, neni 292, fq. 2

153 Po aty, neni 292, fq. 3

154 Po aty, neni 292, fq. 4

155 Po aty, neni 292, fq. 5

156 Po aty, neni 291.

157 Po aty, neni 296, fq. 1, pika 3.

158 Po aty, neni 317a, fq. 1, neni 7 dhe fq. 2 dhe 4

159 Po aty, neni 182.

160 Po aty, neni 7, fq. 1, pila 98a dhe 98b, neni 182a.

Dënimet e parapara për drejtimin e automjetit nën ndikimin e alkoolit:

Nëse keni:

- nga 0,1 deri në 0,3 g/kg alkool në gjak (rreth 2 dcl birrë ose 1 dcl verë), dhe jeni nën 24 vjeç ose shofer fillestar (keni më pak se 12 muaj përvojë drejtimi), do të dënoheni me të holla prej 60 deri në 200 €, ¹⁶¹ndërsa nëse nuk jeni shofer i ri ose shofer fillestar, ky nivel alkooli në gjak është i lejuar. ¹⁶²
- nga 0,3 deri në 0,5 g/kg (rreth 3,5 dcl birrë ose 1,5 dcl verë ose 0,45 dcl pije të fortë alkoolike), do të dënoheni me holla prej 80 deri në 250 €, ¹⁶³
- nga 0,5 deri në 1 g/kg alkool në gjak (rreth 6 dcl birrë ose 2,5 dcl verë ose 0,8 dcl pije të fortë alkoolike), do të dënoheni me gjobë në të holla prej 150 deri në 400 € dhe dy pika penale, krahas masën e mbrojtjes së ndalimit të drejtimin e makinës për një periudhë prej 60 ditësh. Nëse përveç kësaj, keni shkaktuar rrezik të drejtpërdrejtë për pjesëmarrës tjetër në trafik ose keni shkaktuar fatkeqësi komunikacioni, do t'u caktohen edhe dy pika të tjera penale dhe masë mbrojtëse e ndalimit të drejtimin e makinës për një periudhë prej tre muajsh; ¹⁶⁴
- nga 1 deri në 2 g/kg (1,5 l birrë ose 0,8 l verë ose 2,5 dcl pije të fortë alkoolike), ose nëse jeni i paaftë për të drejtuar makinën për shkak të ndikimit të alkoolit, që u konstatua me kontroll profesional, do të dënoheni me gjobë në të holla prej 300 deri në 1.000 € ose me dënimi me burg deri në 60 ditë, dhe do t'ju caktohen tri pika penale, si dhe ndalimi i drejtimit të makinës për tre muaj. ¹⁶⁵ Nëse keni shkaktuar rrezik të drejtpërdrejtë për pjesëmarrës tjetër në trafik ose keni shkaktuar fatkeqësi komunikacioni, do t'ju caktohen edhe dy pika të tjera penale dhe do t'ju përcaktohet ndalim i drejtimit të makinës prej tre deri në gjashtë muaj; ¹⁶⁶
- 2 ose më shumë g/kg (2 l verë ose 4 deri në 5 dcl pije të fortë alkoolike), do të dënoheni me burg nga 15 deri në 60 ditë dhe me 3 pika penale, krahas me masën mbrojtëse të ndalimit të drejtimit të makinës prej katër deri në gjashtë muaj. ¹⁶⁷ Nëse në këto rrethana keni shkaktuar fatkeqësi komunikacioni ose keni shkaktuar rrezik të drejtpërdrejtë për pjesëmarrësit e tjerë në trafik, do t'u caktoheni edhe dy pika tjera penale dhe do t'ju caktohet ndalimi i drejtimit të makinës për gjashtë muaj. ¹⁶⁸

161 Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor, *vërk. cit.*, neni 323, fq. 1, pika 1

162 Po aty, neni 182, fq. 4.

163 Po aty, neni 322, fq. 1, pika 35

164 Po aty, neni 319, fq. 1, pika 19 dhe fq. 3, 4 dhe 6.

165 Po aty, neni 318, fq. 1, pika 14 dhe 3, 4 dhe 6

166 Po aty, neni 318, fq. 4 dhe

167 Po aty, neni 317a, fq. 1, pika 4 dhe fq. 2 dhe 4.

168 Po aty, neni 317a.

Gjoba e propozuar dhe pasojat tjera për drejtimin e automjetit nën ndikimin e drogës dhe substancave psikoaktive të tjera janë të njëjta si ato për rastin e drejtimin nën ndikimin e alkoolit në koncentrimin prej 2 g/kg ose më shumë, siç janë përshkruar në paragrafin e mëparshëm për drejtimin nën ndikimin e alkoolit në koncentrimin e 2 g/kg ose më shumë.

25. A guxoj të refuzoj testimin poligrafik?

Po. Testimi poligrafik kryhet vetëm me pajtimin vullnetar.¹⁶⁹ Poligrafi është një mjet për tentim të zbulimit e së vërtetës, ose më saktë stresit, i krijuar në fillim të shekullit të 20-të (1921) bazuar në studimet e J. A. Larsonit, studentit të mjekësisë në Universitetin e Kalifornisë, i cili integroi instrumente të ndryshme për matjen e frymëmarrjes, presionit të gjakut dhe pulsit në një pajisje të lëvizshme që regjistronte të gjitha këto procese fiziologjike njëkohësisht. Instrumenti që zakonisht përdoret për testimet poligrafike përbëhet nga një "incizues" që vlerëson tre treguesit themelorë: ritmin e zemrës, presionin e gjakut dhe ndjeshmërinë e lëkurës (aktivitetin elektrodermal).¹⁷⁰

Keni të drejtë të jeni të informuar për punën e pajisjes për testimin poligrafik.¹⁷¹ Nëse vendosni t'i nënshtroheni atij, atëherë e jepni pëlqimin tuaj në shkrim. Për të miturit, pëlqimin e jep prindi, ose përkujdesësi ligjor, e nëse përkujdesësi ligjor është personi i dyshuar për veprën penale, pëlqimin do ta japë institucioni kompetent i përkujdesjes sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve.¹⁷² Nëse tërhiqni pëlqimin, testimi do të ndërpritet.¹⁷³ Rezultati i testimin nuk mund të përdoret si provë në procedurën penale. Personi që kryen testimin poligrafik është i obliguar t'u njoftojë se nuk guxoni t'i nënshtroheni një testimi të tillë në qoftë se:

- jeni nën ndikimin e alkoolit, drogave të ndaluara ose ilaçeve për qetësim;
- keni sëmundje serioze të zemrës ose probleme të frymëmarrjes;
- jeni nën stres
- tregoni shenja të sëmundjeve mendore (p.sh., skizofrenie, paranoje...) ose çrregullime të përkohshme të gjendjes mendore (rraskapitja, përgjumja, gjendjet patologjike të shkaktuara nga emocionet e forta ose intoksikimi...);
- ndjeni dhimbje të forta fizike;
- jeni shtatzënë ose në periudhën e lehonisë;
- nuk e keni mbushur moshën 14 vjeçare.¹⁷⁴

169 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër.cit.* neni 119.

170 „Društvena i tehnička istraživanja: Poligraf – poligrafsko testiranje”, Punim profesional, Tomica Starčević (Ministria e Brendshme e Kroacisë) dhe Mr.Sc. Ines Jambrek Petrak (doktorant i studimeve pasuniversitare të doktoraturës të Shkencave të së Drejtës Penale, Fakulteti Juridik në Zagreb), f. 29.

171 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vër.cit.* neni 119

172 Po aty

173 Po aty

174 Po aty

26. A guxoj të refuzoj testimin e ADN-së dhe marrjen e gjurmëve të gishtave?

Testimi i ADN-së (kontrolli trupor - marrja e pështymës) nuk mund të refuzohet kur duhet zbuluar nëse në trupin tuaj ndodhen gjurma veprës penale ose pasojat e saj,¹⁷⁵ ashtu si edhe në rastet kur jeni i dyshuar ose i akuzuar, e duhet të verifikohen faktet e rëndësishme për procesin penal.¹⁷⁶ Ndërkaq marrjen e gjakut mund ta refuzoni nëse kjo do të mund të dëmtonte shëndetin tuaj (për shembull, nëse keni sëmundje kardiovaskulare, karcinom, diabet, glaukomë, anemi...),¹⁷⁷ marrja e mostrave të pështymës nuk mund të refuzohet pasi kjo në asnjë rast nuk konsiderohet si rrezik për shëndetin.¹⁷⁸ E njëjta vlen edhe për marrjen e gjurmëve të gishtave. Ato mund të merren pa miratimin tuaj gjatë privimit nga liria dhe kur ka mundësi të gjenden në objekte që janë të sekuestruara gjatë hetimit për veprën penale për të cilën bëhet ndjekja me obligim zyrtar, siç janë për shembull vrasja ose vjedhja.

27. Kujt duhet t'ia paraqes kërcënimet e marra në internet?

Nëse merrni përmbajtje kërcënuese përmes telefonit celular (aplikacioneve si *Viber*, *WhatsApp*, *Facebook messenger* etj.) ose përmes postës elektronike, ose në formën e komenteve në ndonjë forum interneti ose në rrjetet sociale, këtë mund ta denonconi në polici ose prokurori shtetëror, në formë të shkruar ose me gojë.¹⁷⁹

Policia është e detyruar të pranojë padinë tuaj penale dhe t'ia dërgojë menjëherë prokurorit kompetent shtetëror.¹⁸⁰ Prokurori shtetëror do të hetojë a është kryer veprë penale që ndiqet zyrtarisht, për shembull, rrezikimi i sigurisë suaj ose i personave të afërt me ju me kërcënim.¹⁸¹ Vendimi për padinë penale duhet të merret brenda një muaji, në raste të jashtëzakonshme, më së largu brenda dy muajsh.¹⁸²

Nëse prokurori shtetëror konstaton se bëhet fjalë për kundërvajtje, për shembull, fyerje apo sjellje të paturpshme, ai do t'ia parashtrojë kërkesën për fillimin e procedurës për kundërvajtje gjykatës kompetente për kundërvajtje.¹⁸³ Kjo do të bëhet menjëherë

175 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni. 154

176 Po aty

177 Po aty, neni 154, fq. 2.

178 Po aty, neni 154, fq. 3

179 Po aty, neni 204.

180 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.*, neni 26; Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni. 256, fq. 3

181 Kodi Penal, *vërcit.*, neni 168

182 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 256a, fq. 3 dhe 4

183 Ligji për Rendin dhe Qetësinë Publike, *vërcit.*, neni. 7



pas zbulimit të kundërvajtjes dhe autorit të saj, dhe jo më vonë se në një afat prej 60 dit.¹⁸⁴

Nëse autori nuk është i njohur, në kuadër të Drejtorisë së Policisë, Grupi për Luftimin e Veprave Penale të Krimit të Teknologjisë së Lartë do të tentojë të zbulojë identitetin e autorit.¹⁸⁵

28. Kujt duhet t'ia paraqes veprën penale?

Padia penal dorëzohet te prokurorin kompetent i shtetit.¹⁸⁶ Mirëpo, nëse atë e dorëzoni në polici, gjykatë ose në prokurori që nuk është kompetente, ata janë të obliguar ta pranojnë dhe ta dorëzojnë menjëherë në prokurori të shtetit që është kompetente për ndjekjen e veprës penale që e denonconi.¹⁸⁷

Nëse veprën penale e parashtroni personalisht në prokurori shtetërore, do t'u pranojë prokurori kujdestar, i cili do përpilojë procesverbalin për denoncimin.¹⁸⁸ Padinë penale mund ta shkruani dhe ta dorëzoni në dorëshkrim ose të shtypur. Mund ta dorëzoni

184 Ligji për Kundërvajtje, *vër.cit.*, neni 153

185 Rregullorja për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme e datës 25 shkurt 2022 dhe Rregullorja për Ndryshimet në Rregulloren për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme e datës 2 shkurt 2023.

186 Kodi i Procedurës Penale, *vër.cit.*, neni 256, fq 1

187 Po aty, neni 256 fq 3; Rregullorja për Punën e Brendshme e Prokurorisë së Shtetit, neni. 85. *Fl. zyr. MZ*, nr. 06/16, 29/17 dhe 68/22.

188 Më shumë për mënyrën e paraqitjes së denoncimit penal shikoni në video prezantimin e Prokurorisë së Shtetit të Malit të Zi i: <https://www.youtube.com/watch?v=aiZkSANhmok>

personalisht ose ta dërgoni me email,¹⁸⁹ me faks ose me postë, por edhe mund ta in-cizoni në formën audio ose audio-vizuale . Denoncimi mund t'i bëni edhe me telefon në polici - duke thirrur numrin 122 - dhe për këtë do të bëhet një shkresë zyrtare. Këtë mund ta bëni në çdo kohë, pasi policia punon 24 orë në ditë.¹⁹⁰ Nëse padinë e dorëzoni personalisht, në prezencën tuaj do të përpilohet procesver-bali mbi pranimin e padisë penale, që mund ta lexoni ose të kërkonti t'u lexo-het. Mund të jepni komente në lidhje me tekstin e këtij procesverballi, të cilat zyrtari policor është e obliguar t'i futë para se ta nënshkruani procesverbalin.

Ta keni parasysh se denoncimi i rremë penal është vepër penale, për të cilën parashi-het dënimi me burg prej tre muaj deri në tri vjet (nëse padisni ndonjë person tjetër), dhe një gjobë në të holla ose burg deri në një vit nëse padisni veten.¹⁹¹ Kjo do të tho-të se mund të përgjigjeni penalisht nëse denonconi se ju ose një person tjetër keni kryer një vepër penale, ndërkajë ju e dini se nuk është ashtu. Me gjobë në të holla ose burg deri në një vit do të dënohet ai që denoncon vetëm se është kryer një vepra penale, dhe e di se ajo nuk është kryer.¹⁹²



189 Adresat e postës elektronike të prokurorive të shtetit në Mal të: <https://www.tuzilastvo.me/drtz/sadrzaj/oWwG>

190 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërc.it.*, neni 181

191 Kodi Penal, *vërc.it.*, neni 388

192 Po aty

29. A mund të denoncoj anonimish një vepër penale?

Padija penale mund të jetë anonime dhe me pseudonim. Forma e padisë penale nuk është e caktuar, sepse është më e rëndësishme përmbajtja e saj. Prandaj është e rëndësishme të jepni sa më shumë informata për ngjarjen që po raportoni, bashkë me provat që vërtetojnë pretendimet tuaja. Nëse keni dorëzuar një padi anonime, atëherë nuk do të jeni të informuar lidhur me rezultatin dhe të drejtat që do të kishit në procedurën e më tutjeshëm, por kjo nuk do të thotë që padija nuk do të merret në shqyrtim.¹⁹³



¹⁹³ Shikoni videon në veb faqen e Prokurorisë së Shtetit të Malit të Zi: <https://www.youtube.com/watch?v=aiZkSANhmok>

30. A ka të drejtë policia të ma konfiskojë celularin apo ndonjë send tjetër dhe, nëse e merr, kur është e detyruar të ma kthejë??

Zyrtarët e policisë gjatë bastisjes së banesës, sendeve dhe personave, mund të marrin objekte të lëvizshme (aty llogaritet kompjuteri dhe pajisjet e ngjashme për përpunimin automatik të të dhënave si USB, njësitë e diskut, etj.), dhe duhet t'u japin një vërtetim për konfiskimin e përkohshëm të objekteve.¹⁹⁴ Gjithashtu, policia mund t'ua marrë edhe telefonin celular dhe sendet e tjera personale, për të cilat detyrimisht duhet të nënshkruani një vërtetimin për marrjen ose procesverbalin¹⁹⁵ (shihni nën 11, 12 dhe 13).). Policia mund të marrë objekte në procedurën penale në bazë të vendimit të gjykatës, për ç'gjë mund t'i ankoheni gjykatës së lartë.¹⁹⁶ Objektet e marra përkohësisht (siç është telefoni celular) do t'u kthehen menjëherë nëse nuk do të nisë procesi penal ose i kundërvajtjes, gjegjësisht nëse policia nuk parashtron padi penale brenda tre muajsh.¹⁹⁷ Nëse objektet nuk u kthehen pasi të ndalojnë arsyet për të cilat u janë marrë, keni të drejtë ankesa në polici, ose të padisë gjyqit për rikthimin e sendeve.¹⁹⁸



194 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni 81, fq. 9, neni 82, fq. 1, neni 85, fq. 10

195 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.*, neni 88

196 Kodi i Procedurës Penale, *vërcit.*, neni. 85 fq. 1 dhe 9

197 Po aty, neni 263.

198 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.*, neni 32; Ligji për Marrëdhëniet Juridike Pronësore, *Fl. zyr. MZ*, nr. 19/2009, neni 112, 123/19/2009, čl. 112, 123

31. Kur është policia e detyruar të më ndihmojë?

Standardi themelor i veprimit të policisë është obligim për t'u shërbyer njerëzve me qëllim të sigurimit të respektimit të drejtave të njeriut dhe mbrojtës së ligjshmërisë.¹⁹⁹ Kjo përfshin ndihmën për njerëzit e kërcënuar dhe për të tjerët që kanë nevojë për ndihmë.²⁰⁰ Edhe kur nuk është në detyrë, zyrtari i policisë është i detyruar t'u përmbahet standardeve dhe t'i ofrojë ndihmë çdo personi që ndodhet në rrezik, të parandalojë kryerjen e veprave penale etj.²⁰¹

Zyrtarët e policisë, për shembull:

- duhet t'u ndihmojnë pjesëmarrësve në trafik (p.sh. kur automjeti i tyre ndalet në rrugë) për sigurinë më të lartë në komunikacion dhe për qarkullimin pa pengesa;
- duhet të sigurojnë ndihmën mjekësore kur ka nevojë për të (p.sh. në rastet kur hasin në të lënduarit në vendin e kryerjes së një vepre penale),²⁰²
- duhet të marrë gjëra të gjetura nga gjetësi (p.sh. dokumente personale, para ose vlera të tjera) dhe të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të ruajtur këtë, për të gjetur personin që e ka humbur dhe për t'ia kthyer sendin.²⁰³

Zyrtarët e policisë janë të obliguar të ndërmarrin veprime të nevojshme për të mbrojtur jetën e njerëzve, madje edhe atëherë kur gjatë kryerjes së detyrave policore rrezikojnë jetën e vet.²⁰⁴



199 Ligji mbi Punët e Brendshme, *vërcit.*, neni 20, fq. 2

200 Po aty. Shih gjithashtu neni 18 (Çështjet e Policisë) dhe 19 (Parimet dhe Objektivat e Çështjeve Policore)

201 Po aty neni 22. Shih gjithashtu Kodin e Etikës Policore, *Fl. zyr. MZ*, nr. 87/21, neni 7

202 Po aty, neni 122

203 Po aty, neni 27

204 Po aty, neni 23

32. A mund të më dënojë policia nëse e pengoj ose e fyej zyrtarin e policisë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare?

Nëse pengoni, nënçmoni, sulmoni ose në ndonjë mënyrë tjetër përpiqeni të pengoni zyrtarët e policisë të kryejnë detyrën zyrtare në mënyrë ligjore, ju i nënshtroheni përgjegjësisë së kundërvajtjes ose asaj penale .

Për *kundërvajtje* mund të dënoheni me gjobë në të holla prej 500 deri në 1,500 € ose me burgim deri në 60 ditë, për pengimin ose nënçmimin e personit zyrtar.²⁰⁵ Dënimi me burgim është i njëjtë edhe nëse kundërvajtjen e kryeni si anëtar i një grupi, ndërsa gjoba në para lëviz prej 500 deri në 2,000 €. ²⁰⁶

Përgjegjësi penale mund të keni nëse e pengoni apo tentoni të pengoni zyrtarin e policisë në kryerjen e veprimit zyrtar me dhunë ose me kërcënim se do ta përdorni drejt-përdrejtë dhunën.²⁰⁷ E njëjta vlen, nëse e detyroni ose tentoni ta detyroni atë të kryejë një veprim. Në raste të tilla mund të dënoheni me burgim prej gjashtë muajsh deri në pesë vjet.²⁰⁸

Do të përgjigjeni penalisht edhe nëse sulmoni ose përpiqeni të sulmoni zyrtarin e policisë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ose nëse atë e kërcënoni me sulm.²⁰⁹ Për një rast të tillë është kërcënuar dënimi me burg nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Megjithatë, ju mund të liroheni nga përgjegjësia nëse jeni provokuar nga sjellja e paligjshme ose e paturpshme e zyrtarit të policisë.²¹⁰

205 Ligji për rendin dhe paqen publike, *vërcit.*, neni 11, fq. 1

206 Po aty, neni 11, fq. 2

207 Kodi Penal, *vërcit.*, neni 375


208 Po aty, neni 375, fq. 3

209 Po aty, neni 376, fq. 1 dhe 3

210 Po aty, neni 375, fq. 5 dhe 376. Ligji për rendin dhe paqen publike, neni. 11, fq. 1

33. A kam të drejtë t'i incizoj me celular zyrtarët e policisë?

Në përgjithësi, ju mund të incizoni zyrtarët e policisë në një vend publik, sepse ata janë zyrtarë publikë dhe puna e tyre është e hapur për publikun.²¹¹ Nëse një zyrtar policie u paralajmëron se incizimi juaj po i pengon në kryerjen e detyrës, largohuni, por incizimin mund të vazhdoni pa e penguar më.²¹²



211 Konkluzion i Këshillit për Kontroll Qytetar të Punës Policore Nr.: 53/14-18, 07.02.2020, fq.2.

212 Po aty

CIP - Katalogizimi në publikim
Nacionalna biblioteka Crne Gore, Cetinë

ISBN 978-9940-642-20-4
COBISS.CG-ID 28363524

ISBN 978-9940-642-20-4

